REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 shkurt 2025
Nr. ref.:AGJ 2650/25

# AKTGJYKIM

në

**rastet nr. KI75/23 dhe KI225/23**

Parashtrues

**Ilir Efendija dhe Ilir Beqiri**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në lëndën [P. nr. 724/15] në Gjykatën Themelore në Gjakovë**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar
Jeton Bytyqi, gjyqtar

## Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI75/23 është parashtruar nga Ilir Beqiri, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i parë i kërkesës), të cilin e përfaqëson Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

2. Kërkesa KI225/23 është parashtruar nga Ilir Efendija, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i dytë i kërkesës), të cilin në Gjykatë e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat nga Gjakova (në tekstin mëtejmë të referuar bashkërisht si: parashtruesit e kërkesave).

## Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës nuk kontestojnë ndonjë akt konkret të autoriteteve publike, por kontestojnë kohëzgjatjen e procedurës penale përkitazi me gjykimin e lëndës me numër [P.nr. 724 /15] në Gjykatën Themelore në Gjakovë – Departamentin e Përgjithshëm, Divizioni Penal (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

## Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës penale përkitazi me gjykimin e lëndës [P.nr. 724 /15] në Gjykatën Themelore. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin mëtejmë: KEDNJ).

## Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

6. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit te saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 25 mars 2023, parashtruesi i parë i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij përmes postës, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) e pranoi më 31 mars 2023.

8. Më 13 prill 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI75/23] caktoi Gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI75/23] kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).

9. Më 25 prill 2023, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e pretenduar të parashtruesit të parë të kërkesës për regjistrimin e kërkesës, të cilit ia kërkoi autorizimin specifik për përfaqësimin e tij.

10. Më 11 maj 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës së parë përmes postës ia dorëzoi Gjykatës autorizimin për parashtruesin e kërkesës dhe informata shtesë.

11. Më 31 korrik 2023, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore përkitazi me regjistrimin e kërkesës së parashtruesit të parë dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës kësaj të fundit, me mundësinë për të dhënë komente në lidhje me rastin.

12. Më 3 gusht 2023, Gjykata Themelore përkitazi me kërkesën e parashtruesit të parë i dorëzoi Gjykatës komente.

13. Më 10 tetor 2023, parashtruesi i dytë i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij përmes postës, të cilën Gjykata pranoi më 16 tetor 2023.

14. Më 16 tetor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI225/23] caktoi Gjyqtarin Enver Peci gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI225/23] kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).

15. Më 25 tetor 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesin e dytë të kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

16. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

17. Më 22 mars 2024, Gjykata i kërkoi Gjykatës Themelore një kopje të: (i) Aktgjykimit [P.nr.724/15] të 2 majit 2023, të Gjykatës Themelore; si dhe (ii) Ankesës së parashtruar nga parashtruesi i parë i kërkesës, në Gjykatën e Apelit.

18. Më 5 prill 2024, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës dokumentet e kërkuara përmes shkresës së 22 marsit 2024.

19. Më 9 shtator 2024, në pajtim me paragrafin 1 të rregullit 32 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së Punës, përmes Urdhrit [Urdh. KI75/23 dhe KI225/23], Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI225/23 me kërkesën KI75/23. Bazuar në paragrafin 2 të rregullit të lartcekur, për kërkesat e bashkuara, gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues mbetet në përbërje të njëjtë, siç është përcaktuar për kërkesën e parë, përkatësisht atë KO232/23.

20. Më 18 shtator 2024, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesave dhe Gjykatën Themelore për regjistrimin dhe bashkimin e tyre.

21. Më 24 shtator 2024, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës dosjen origjinale të lëndës [P.nr.724/15].

22. Më 10 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-1/24], të 10 dhjetorit 2024, Gjyqtari Nexhmi Rexhepi u zgjodh Kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimit të lartcekur të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtari Nexhmi Rexhepi, detyrën e Kryetarit të Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, më 30 dhjetor 2024. Të njëjtën ditë, përkatësisht më 10 dhjetor 2024, përmes Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-2/24] Gjyqtari Safet Hoxha u zgjodh Zëvendëskryetar i Gjykatës, dhe bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimit të lartcekur të Gjykatës u përcaktua që Gjyqtari Safet Hoxha, detyrën e Zëvendëskryetarit e merr me 11 dhjetor 2024.

23. Më 23 dhjetor 2024, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, me Vendimin [nr.ref.: KK 1009/24] vendosi që gjyqtari Nexhmi Rexhepi të caktohej kryesues i Kolegjeve

shqyrtuese në rastet në të cilat ai më herët ishte caktuar si anëtar i Kolegjit Shqyrtues, përfshirë edhe rastin aktual.

24. Më 30 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-1/24], të 10 dhjetorit 2024 të Gjykatës, gjyqtari Nexhmi Rexhepi mori detyrën e Kryetarit të Gjykatës, ndërsa bazuar në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Gresa Caka-Nimani përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

25. Në të njëjtën ditë, bazuar në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 të Ligjit, edhe Gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi përfundoi mandatin e gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

26. Më 8 janar 2025, Kryetari Gjykatës Nexhmi Rexhepi, përmes Vendimit KSH.KI75/23 caktoi gjyqtarin Safet Hoxha anëtar në Kolegjin Shqyrtues në vend të Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, mandati i së cilës si gjyqtare kishte përfunduar më 30 dhjetor 2024. Bazuar në pikën I të vendimit të lartcekur, Kolegji Shqyrtues ka këtë përbërje: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Safet Hoxha dhe Enver Peci (anëtarë).

27. Më 28 janar 2025, Gjykata ia ktheu Gjykatës Themelore dosjen origjinale të lëndës.

28. Më 5 shkurt 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri votash i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesave. Në të njëjtën ditë, Gjykata në përbërje të plotë pas këshillimit, njëzëri vendosi: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; si dhe (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.

**Përmbledhja e fakteve**

29. Nga dosja e lëndës rezulton se parashtruesit e kërkesave më 3 maj 2003, në cilësinë e specialistëve të otorinolaringologjisë dhe anestezionit, kishin operuar personin A.G në Spitalin Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë, i cili pas këtij intervenimi kirurgjik, rreth orës 01:14 të ditës së nesërme, kishte ndërruar jetë.

30. Më 2 shkurt 2006, Prokuroria Publike e Qarkut në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Prokuroria Publike) përmes Aktvendimit [PPHQ-nr.26/06], filloi hetimet kundër parashtruesit të dytë të kërkesës, sepse u dyshua që kishte kryer veprën penale "*Trajtimi i pa ndërgjegjshëm mjekësor*" nga paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 të nenit 219 (Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK).

31. Më 5 prill 2006, Prokuroria Publike përmes Aktvendimit [PPHQ.nr.26/05], zgjeroi hetimet edhe kundër parashtruesit të parë të kërkesës për veprën penale të lartcekur.

32. Më 7 qershor 2006, Prokuroria Publike ngriti aktakuzën [PP.nr.567/03] kundër parashtruesve të kërkesave për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale nga paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 të nenit 219 të KPRK-së në bashkëkryerje, të përcaktuar me nenin 23 (Bashkëkryerja) të KPRK-së.

33. Më 07 shtator 2006, Gjykata e Qarkut në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Qarkut), përmes Aktvendimit [KAQ.nr. 274/06], konfirmoi aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Publike.

34. Më 13 tetor 2006, Gjykata e Qarkut përmes Aktvendimit [KP.nr.49/06] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të parë të kërkesës kundër aktvendimit të lartcekur mbi konfirmimin e aktakuzës.

35. Më 14 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut përmes Aktgjykimit [P.nr. 187/2007], (i) shpalli fajtorë parashtruesit e kërkesës për veprën penale *"Trajtim i pa ndërgjegjshëm mjekësorë"* nga paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 të nenit 219 dhe nenin 23 të KPRK-së, dhe (ii) dënoi të njëjtit me dënim të kushtëzuar me burgim prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohej për kohën prej 2 (dy) vitesh, nëse të dënuarit nuk kryejnë vepër tjetër penale.

36. Më 23 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut përmes Aktvendimit [P.nr. 185/07] mbi përmirësimin e aktgjykimit, përmirësoi Aktgjykimin [P.nr. 187], e saj, të 14 shkurtit 2011, *"[...] ashtu që në vend të numrit P.nr. 187/07 duhet të jetë numri P.nr. 185/07 dhe atë në pjesën hyrëse dhe në fund të arsyetimit të aktgjykimit"*

37. Më 3 mars 2011, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë kundër Aktgjykimit [P.nr. 187/2007], të 14 shkurtit 2011, të Gjykatës së Qarkut.

38. Më 27 shtator 2012, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), përmes Aktvendimit [Ap.nr. 159/2011], (i) aprovoi ankesat e parashtruesve të kërkesës dhe (ii) anuloi Aktgjykimin [P.nr. 187/2007], e 14 shkurtit 2011, të Gjykatës së Qarkut, përmes të cilit parashtruesit e kërkesave ishin dënuar me burgim, si dhe ktheu çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

39. Në arsyetimin e aktvendimit të saj, Gjykata Supreme theksoi: *"[...] Gjykata e shkallës së parë ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 15 dhe 5 të KPPK, pasi që në shkresat e lëndës të shpallura si prova të papranueshme nuk i ka veçuar nga shkresat e lëndës, nuk i ka mbyllur, vulosur dhe ruajtur të ndara nga shkresat tjera të lëndës.*
*Sipas paragrafit 6 të nenit 154 të KPPK, gjykata ka pasur mundësi provën e papranueshme gjatë fazës së më vonshme të procedurës me aktvendim ta shpall si provë të pranueshme. Pasi që u vërtetua se Aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 pika 8 të KPPK, Aktgjykimi i ankimuar u anulua. [...]".*

40. Nga shkresat e lëndës rezulton se çështja juridike penale e parashtruesve të kërkesave u transferua nga Gjykata Themelore në Pejë në Gjykatën Themelore në Gjakovë.

41. Më 5 mars 2015, Gjykata Themelore në Gjakovë përmes Aktvendimit [PKR.nr.434/2012] të 5 marsit 2015, e shpalli veten jo kompetente në pikëpamje territoriale dhe lëndorë për të vendosur në lidhje me aktakuzën e parashtruesve të kërkesave.

42. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i parë i kërkesës parashtroi ankesë kundër Aktvendimit [PKR.nr.434/2012], të 5 marsit 2015 të Gjykatës Themelore.

43. Më 23 mars 2015, Gjykata e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) përmes Aktvendimit [PN. Nr. 169/2015] aprovoi ankesën e parashtruesit të parë të kërkesës dhe ndryshoi Aktvendimin PKR.nr.434/2012], të 5 marsit 2015 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, ashtu që të njëjtën e shpalli kompetente në pikëpamje territoriale dhe lëndore.

44. Më 22 tetor 2015, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për refuzimin ose lirimin nga aktakuza e tyre.

45. Nga shkresat e lëndës rezulton se në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i dytë i kërkesës kërkoi transferimin e lëndës nga Departamenti i Krimeve të Rënda në Departamentin e Përgjithshëm brenda Gjykatës Themelore.

46. Më 18 tetor 2016, gjyqtarja e çështjes juridike penale në Gjykatën Themelore lëshoi deklaratë në lidhje me kërkesën për përjashtim të parashtruesit të dytë të kërkesës, me ç'rast konstatoi se: "*Pjesëmarrësit në procedurë nuk kanë vërejtje lidhur me kalimin e lëndës nga Departamenti i Krimeve të Rënda në Departamentin e Përgjithshëm*".

47. Më 3 tetor 2022, parashtruesit e kërkesave parashtruan kërkesë për hedhjen e aktakuzës.

48. Në mes të datave 18 tetor 2022 dhe 27 prill 2023, Gjykata Themelore mbajti gjithsej 12 (dymbëdhjetë) seanca gjyqësore, respektivisht, në datat si në vijim: (i) 18 tetor 2022; (ii) 23 nëntor 2022; (iii) 15 dhjetor 2022; (iv) 19 janar 2023, (v) 14 shkurt 2023; (vi) 9 mars 2023; (vii) 21 mars 2023; (viii) 23 mars 2023; (ix) 30 mars 2023; (x) 19 prill 2023; (xi) 24 prill 2023; (xii) 27 prill 2023, në të cilat u dëgjuan dëshmitarë dhe ekspertë.

49. Më 02 maj 2023, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P.nr. 724/15], liroi nga akuza parashtruesit e kërkesave, me arsyetimin se veprimet e tyre nuk i kanë përmbushur elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohen.

50. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i parë i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër pikës së Aktgjykimit [P .nr. 724/15], të 2 majit 2023, të Gjykatës Themelore, përkitazi me shpenzimet e mbrojtjes, me propozimin që të njëjtat të paguhen në lartësinë prej 4,104 (katër mijë e njëqind e katër) euro.

51. Më 30 maj 2023, Prokuroria Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Prokuroria Themelore) parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [P.nr. 724/15] të 2 majit 2023, të Gjykatës Themelore Gjakovë, për shkak të: (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale; (ii) vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike; si dhe (iii) shkeljes së ligjit penal.

52. Më 13 nëntor 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA.nr.790/23] refuzoi si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore ankesat e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [P.nr. 724/15], e 2 majit 2023, të Gjykatës Themelore.

**Pretendimet e parashtruesve të kërkesës**

53. Parashtruesit e kërkesave kontestojnë kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës penale në Gjykatën Themelore, përkitazi me lëndën [P.nr. 724 /15], për të cilin parashtruesit e kërkesave pretendojnë se i cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të tyre të garantuara në paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

54. Parashtruesit në kërkesat e tyre i referohen praktikës gjyqësore të Gjykatës në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, respektivisht, garancisë për gjykim në kohë të arsyeshme, si në rastin KI06/21 [parashtrues *Dragan Mihajloviq*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022).

*Pretendimet e parashtruesit të parë të kërkesës, kërkesa KI75/23*

55. Parashtruesi i parë i kërkesës thekson se: *"Në këtë çështje hetohet se Prokuroria e shtetit, Prokurorët parashtronin propozime për prova krejtësisht të pa nevojshme në përpjekje*

*që të prolongohet procedura deri sa të arrihet parashkrimi absolut me dt. 03.05.2003. Kjo është aritmetike e Prokurorisë, nga se e kanë në dijeni se aktakuza do të iu dështoj, kështu që kur të arrihet parashkrimi, Gjykata nuk vendos në meritum, dmth. nuk mundë të bie aktgjykim lirues, nga se nëse bie Aktgjykim lirues, del se Prokuroria ka dështuar profesionalisht, zyrtarisht dhe moralisht. Andaj, me arritje te parashkrimit çështja mbyllet në kuptim të nenit 362 par. 1.3. të Kodit të ri të procedurës penale të Kosovës, me Aktgjykim refuzues."*

56. Parashtruesi përfundimisht kërkon nga Gjykata që (i) të konstatojë shkeljen e paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të 6 të KEDNJ-së, si dhe (ii) t'ia kompensojë shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro, me kamatë dhe shpenzime procedurale.

*Pretendimet e parashtruesit të dytë të kërkesës, kërkesa KI225/23*

57. Në kontekst të pretendimeve për shkeljen e paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i dytë i kërkesës parë thekson se: *"[...] ky proces i parashtruesit të kërkesës i ka shkaktuar bezdi dhe shqetësime të jashtëzakonshme, dhe i është shkaktuar edhe cenim i prestigjit dhe autoritetit, duke i pamundësuar avancimin në karrierë. I janë krijuar shpenzime të konsiderueshme, pasi që duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, parashtruesi i kësaj kërkese ka pasur të angazhuar një avokat mbrojtës."*

58. Parashtruesi po ashtu i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), respektivisht rastin *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, [nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982 paragrafi 73], për të cilin pretendon se ndërlidhet me rrethanat konkrete të shkeljes së pretenduar nga procedurat në Gjykatën Themelore.

59. Gjithashtu, ai pretendon se më 4 maj 2023, vepra penale për të cilën është akuzuar, ka arritur afatin e parashkrimit absolut të ndjekjes penale, për faktin se për të njëjtën çështje konkrete kanë kaluar 20 (njëzetë) vjet nga dita kur pretendohet se është kryer vepra penale dhe në këtë kontekst thekson se: *"Prokurori i çështjes përkundër PARASHKRIMIT ABSOLUT PARAQET ANKESË. Ky veprim i Gjykatës së shkallës së parë dhe ankesa e Prokurorit është kalkulim që lënda të parashkruhet në dorë të Gjykatës së Apelit e jo sa ishte në punë në Gjykatën Themelore në Gjakovë dhe Prokurorinë Themelore në Gjakovë".*

**Komentet e Gjykatës Themelore, të 3 gushtit 2023, përkitazi me kërkesën e parashtruesit të parë**

60. Më 3 gusht 2023, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës komente përkitazi me kërkesën e parashtruesit të parë, ku, ndër të theksoi se: *"Duke iu kërkuar falje që nuk të japim përgjigje në mënyrë të detajuar lidhur me këtë çështje, por është fakt se Gjykata Themelore në Gjakovë, ka pasur në procedurë çështjen penale lëndën me numër P.nr.724/15, në numër të sistemit elektronik Smil:2022:133184, ku ka qenë në vendosje tek Gjykatësja [I.H], e cila çështje ka marr epilog përfundimtarë ku edhe është vendosur sipas aktgjykimit lirues P.nr. 724/15 të dt. 02.05.2023, për të cilën çështje palët kanë parashtruar ankesë dhe tani kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë me ankesë, e cila lëndë nga Gjykata jonë është përcjellë sipas ankesës dhe është pranuar me dt. 23.06.2023 në Gjykatën e Apelit dhe për këtë arsye nuk mund të paraqesim përgjigje të detajuar lidhur me këtë kërkesë."*

**Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

**KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**Neni 31**
**[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

*"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
*2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
*[...]"*

**KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT [e miratuar më 4 nëntor 1950 nga Këshilli i Evropës]**

**Neni 6**
**(E drejta për gjykim të drejtë)**

*"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm [...]."*

**KODI I PËRKOHSHËM I PENAL I KOSOVËS**

**Kapitulli I: Dispozitat e Përgjithshme**
**Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale**

**Neni 23**
**(Bashkëkryerja)**

*"Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepra penale."*

**Kapitulli IX: Parashkrimi**

**Neni 90**
**(Parashkrimi i ndjekjes penale)**

*"(1) Me përjashtim të rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse nuk kanë kaluar afatet e mëposhtme:*
*[...]*
*3) Dhjetë vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë vjet burgim;*
*[...]*
*(2) Nëse për veprën penale është paraparë më shumë se një dënim, afati i parashkrimit për ndjekjen penale caktohet sipas dënimit më të rëndë."*

**Neni 91**
**(Fillimi dhe ndërprerja e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale)**

*"[...]*
*(6) Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale)."*

**Kapitulli XXI: Veprat penale kundër shëndetit publik**

**Neni 219**
**(Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor)**

*"(1) Mjeku i cili me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore përdor haptas një mjet apo metodë të papërshtatshme të mjekimit ose nuk përdor masa përkatëse higjienike dhe me këtë shkakton keqësimin e gjendjes shëndetësore të personit dënohet me burgim deri në tri vjet.*
*(2) Punonjësi shëndetësor i cili me rastin e dhënies së ndihmës ose të trajtimit shëndetësor vepron në mënyrë të pandërgjegjshme dhe me këtë shkakton keqësimin e gjendjes shëndetësore të personit dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.*
*(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me burgim deri në një vit.*
*(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni shkakton lëndim të rëndë trupor apo çfarëdo dëmtimi të rëndë të shëndetit të personit, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose 2 ose me burgim deri në tre vjet për veprën nga paragrafi 3.*
*(5) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose 2, ose me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën penale nga paragrafi 3."*

## Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

61. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesat i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

62. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

Nenit 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

*"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

63. Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të parashikuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa Individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që parashohin:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

*"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

*"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

Neni 49
(Afatet)

*"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]".*

64. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesave pretendojnë tejzgjatje të procedurës penale përkitazi me gjykimin e lëndës [P.nr. 724 /15] në Gjykatën Themelore, sipas aktakuzës [PP.nr.567/03], të ngritur më 7 qershor 2006 nga Prokuroria Publike. Nga shkresat e dosjes së plotë të çështjes penale rezulton se pas regjistrimit të kërkesave të parashtruesve para Gjykatës, më 13 nëntor 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA.nr.790/23] vërtetoi Aktgjykimin [P.nr. 724/15], e 2 majit 2023, të Gjykatës Themelore.

65. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesit e kërkesës specifikojnë se atyre i janë shkelur të drejtat e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, gjegjësisht, *"gjykim në afat të arsyeshëm kohor"* e garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KENDJ-së, duke qenë se procedura penale ndaj tyre kishte zgjatur më shumë se 20 (njëzet) vjet, me ç'rast, reputacioni i tyre në profesionin e mjekëve ishte dëmtuar.

66. Në kontekst të (ii) shterimit të mjeteve juridike, të përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit; dhe (ii) dorëzimin e kërkesës në afatin e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, Gjykata thekson se në momentin e paraqitjes së kërkesës së parashtruesit të parë, respektivisht, më 25 mars 2023 ishte ende duke u shqyrtuar nga Gjykatën Themelore, ndërsa në momentin e parashtrimit të kërkesës së parashtruesit të dytë, gjegjësisht më 10 tetor 2023, e njëjta ishte vendosur shkallë të parë përmes Aktgjykimit [P.nr. 724/15] lirues për parashtruesit e kërkesës, të 2 majit 2023, të Gjykatës Themelore, si dhe nga shkresat e dosjes së plotë të çështjes penale rezulton se çështja e parashtruesve të kërkesës ka përfunduar me Aktgjykimin [PA.nr.790/23] e 13 nëntorit, të Gjykatës së Apelit. Duke qenë se parashtruesit e kërkesës nuk kontestojnë ndonjë akt konkret të autoriteteve publike, por vetëm kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e çështjes së tyre penale brenda një afati të arsyeshëm kohor, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se kërkesat e parashtruesve janë të pranueshme në kuptim të nenit 49 të Kushtetutës.

67. Gjykata gjithashtu konstaton se parashtruesit kanë saktësuar kërkesat e tyre ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit si dhe konsideron se kërkesat nuk janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, prandaj ato duhet deklaruar të pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e tyre.

**Meritat**

68. Gjykata në vijim, vë në pah se pretendimin e lartcekur të parashtruesve të kërkesave për tejzgjatje të procedurës penale, e cila ka përfunduar përmes Aktgjykimit [PA.nr.790/23], të 13 nëntorit 2023, të Gjykatës së Apelit, do ta trajtojë nga këndvështrimi i të drejtave të garantuara me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, duke aplikuar në këtë rast edhe parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ, në të cilin rast Gjykata në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e obliguar që *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*.

69. Në lidhje me të drejtën për nxjerrjen e vendimeve brenda afatit të arsyeshëm kohor, Gjykata i referohet paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, të cilët përcaktojnë që:

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

*"[...]*
*2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet [...] brenda një afati të arsyeshëm [...]".*

Neni 6
(E drejta për gjykim të drejtë)

*"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm ...".*

70. Përkitazi me shkeljen e të drejtës kushtetuese lidhur me gjykimin e rasteve brenda afatit të arsyeshëm kohor, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore lidhur me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshmë në kontekst të procedurave civile (shih, ndër tjerash rastet KI183/21, parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 marsit 2022; KI03/22, parashtrues *EPS "Trgovina",* Aktvendim për papranueshmëri i 29 shtatorit 2022; KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim i 11 gushtit 2022; KI09/21, parashtrues *Dragan Mihajloviq*, Aktgjykim i 2 shkurtit 2023, KI02/22, parashtrues "*Elektrosever" sh.p.k.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2022; KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha,* Aktgjykim i 31 gushtit 2023; KI152/23, parashtrues *Burim Zherka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 qershorit 2024; dhe KI255/23, parashtrues *Genc Qorri*, Aktvendim për Papranueshmëri i 30 tetorit 2024. Përderisa, në kontekst të pretendimeve që ndërlidhen me cenimin e kësaj të drejte në procedurë penale, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, të cilat, ndër tjerash përfshijnë rastet *Wemhoff kundër Gjermanisë*, nr. 2122/64, Aktgjykim i 27 qershorit 1968; *Milasi kundër Italisë*, nr. 10527/83, Aktgjykim i 26 janarit 1987; *Baggeta kundër Italisë*, nr. 10256/83, Aktgjykim i 25 janarit 1983; *B. kundër Austrisë*, nr. 11968/86, Akgjykim i 23 shkurtit 1990; *Rouille kundër Francës*, nr. 50268/99, Aktgjykim i 6 janarit 2004; *Clinique Mozart Sarl kundër Francës,* nr.

46098/99, Aktgjykim i 8 qershorit 2004; *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; *Neumeister kundër Austrisë*, nr. 1936/63, Aktgjykim i 27 qershorit 1968).

71. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata rithekson se parashtruesit e kërkesave pretendojnë tejzgjatje të procedurës penale, në kundërshtim me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, e cila situatë paraqitet për herë të parë para Gjykatës duke qenë se më lart u theksua se rastet e mëhershme kishin të bëjnë me kërkesa të natyrës civile.

72. Në pajtim me parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, gjatë shqyrtimit të pretendimit të parashtruesve të kërkesave, Gjykata do të merr parasysh: (i) vërtetimin e kohëzgjatjes së procedurës në tërësi në gjykatën kompetente, përkatësisht Gjykatën Themelore; (ii) parimet relevante në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës; dhe (iii) arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave në Gjykatën Themelore.

### *(i) Periudha që do të merret parasysh*

73. Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në kontekst të kohëzgjatjes së procedurave penale, vlerëson se periudha që do të merret në konsideratë fillon në ditën kur një personi i ngritët aktakuza *(*shih rastin e GJEDNJ-së, *Neumeister kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 18). GJEDNJ gjithashtu konsideron se "*koha e arsyeshme"* mund të fillojë përpara se çështja të dalë para gjykatës së shkallës së parë (*Deweer kundër Belgjikës*, nr. 6903/75, Aktgjykim i 27 shkurtit 1980, paragrafi 42), për shembull nga (i) koha e arrestimit (*Wemhoff kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 19), (ii) gjatë kohëzgjatjes së hetimeve në procedurë paraprake (*Ringeisen kundër Austrisë*, nr. 2614/65, Aktgjykim i 22 qershorit 1971, paragrafi 110; *Šubinski kundër Sllovenisë*, nr. 19611/04, Aktgjykim i 18 janarit 2007, paragrafët 65-68), ose (iii) marrjes në pyetje të dëshmitarit, i cili dyshohet për kryerjen e një vepre penale (*Kalēja kundër Letonisë*, nr. 22059/08, Aktgjykim i 5 tetorit 2017, paragrafi 40). Megjithatë, në çdo rast, momenti përkatës është kur parashtruesit vihet në dijeni për akuzën ose kur ai ose ajo preket ndjeshëm nga masat e marra në kontekstin e hetimeve ose procedurave penale (shih rastet e GJEDNJ-së, *Mamič kundër Slovenia (nr.2)*, nr. 75778/01, Aktgjykim i 27 korrikut 2006, paragrafët 23-24); *Liblik dhe të tjerë kundër Estonisë*, nr. 173/15 dhe 5 të tjerë, Aktgjykim i 28 majit 2019, paragrafi 94).

74. Gjykata vlerëson se parashtruesve të kërkesës iu është ngritur aktakuza më 7 qershor 2006, aktakuzë e cila është shqyrtuar edhe pas 15 qershorit 2008, kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi, deri më 13 nëntor 2023, kur procedura penale kishte përfunduar me Aktgjykim lirues të Gjykatës së Apelit.

75. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave kishin parashtruar kërkesat e tyre më 25 mars 2023 dhe më 10 tetor 2023, respektivisht. Në vijim të kësaj, Gjykata vëren se periudha e cila duhet të merret parasysh në vlerësimin e pretendimit për tejzgjatje të procedurës penale nga Gjykata për parashtruesin e parë të kërkesës KI75/23 është: 14 (katërmbëdhjetë) vjet e 9 (nëntë) muaj e 10 (dhjetë) ditë, ndërsa për parashtruesin e dytë të kërkesës KI225/23, është: 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, 3 (tre) muaj e 25 (njëzet e pesë) ditë.

### *(ii) Parimet relevante*

76. Gjykata para se gjithash thekson se sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës në kontekst të procedurave civile, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së të cilave nuk dallon nga ato të procedurave penale për shkak se të njëjtat duhet të vlerësohen në dritën e

rrethanave të rastit, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, përkatësisht, kriteret që i referohen janë: (a) ndërlikueshmëria e rastit; (b) sjellja e palëve në procedurë; (c) sjellja e gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (d) rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest (shih, rastet e GJEDNJ-së në kontekst të procedurave penale, *(König kundër Gjermanisë,* nr. 6232/73, Aktgjykim i 28 qershorit 1978, paragrafi 99; *Neumeister kundër Austrisë,* cituar më lart, paragrafi 21*; Ringeisen kundër Austrisë,* cituar më lart, paragrafi 110*; Pélissier dhe Sassi kundër Francës [DhM],* nr. 25444/94, Aktgjykim i 25 marsit 1999, paragrafi 67; *Pedersen dhe Baadsgaard kundër Danimarkës [DhM],* no. 49017/99, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2004, paragrafi 45*; Chiarello kundër Gjermanisë,* nr. 497/17, Aktgjykim i 20 qershorit 2019, paragrafi 45*; Liblik dhe të tjerët kundër Estonisë,* cituar më lart, paragrafi 91*)*.

### *(i) Analiza e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës*

77. Ashtu siç është elaboruar edhe më lart, Gjykata vë në pah se parashtruesve të kërkesave iu është ngritur aktakuza më 7 qershor 2006. Në vijim të kësaj, për të konstatuar nëse procedura penale e zhvilluar pranë Gjykatës Themelore përbën tejzgjatje të procedurës penale, Gjykata duhet të merr parasysh faktorët si në vijim: (a) ndërlikueshmërinë e rastit; (b) sjelljen e parashtruesve të kërkesave; (c) sjelljen e autoriteteve relevante gjyqësore; dhe (d) rëndësinë e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin e kërkesës në kontest.

78. Gjykata përsëritë se thelbi i këtij rasti konsiston në faktin se më 7 qershor 2006 parashtruesve të kërkesave iu kishte ngritur aktakuza nën dyshimin se në vitin 2003, në cilësinë e mjekëve në bashkëkryerje kishin kryer veprën penale "*Trajtimi i pa ndërgjegjshëm mjekësor*" nga paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 të nenit 219 të KPRK-së, për të cilën akuzë në vitin 2011, u shpallën fajtor dhe u dënuan nga Gjykata e Qarkut me dënim të kushtëzuar me burgim prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohej për kohën prej 2 (dy) vitesh, nëse të dënuarit nuk kryejnë vepër tjetër penale, aktgjykim i cili u kthye në rivendosje nga Gjykata Supreme më 27 shtator 2012. Gjykata Themelore më 2 maj 2023, liroi parashtruesit e kërkesave nga akuza, i cili akgjykim u vërtetua nga Gjykata e Apelit më 13 nëntor 2023.

79. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se objekt i çështjes në vlerësimin e këtyre kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës penale kundër parashtruesve të kërkesës me numër [P. nr. 724/15] në Gjykatën Themelore, përkitazi me aktakuzën e ngritur më 7 qershor 2006, respektivisht 15 qershor 2008, prej kur edhe ka juridiksion kohor Gjykata.

*(a) Ndërlikueshmëria e rastit*

80. Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së përmes të cilave ishte theksuar se ndërlikueshmëria e rastit mund të ndërlidhet me (i) numrin e aktakuzave; (ii) numrin e palëve në procedurë, siç janë të pandehurit dhe dëshmitarët; (iii) nëse rasti përfshin elementin të huaj (ndërkombëtar), me ç'rast përfshihen disa shtete, asistenca e INTERPOL-it, apo zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare për ndihmë juridike reciproke (shih rastin e GJEDNJ-së, *Neumeister kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 20); (iv) nëse rasti përbën dyshime për "*krime të jakës së bardhë",* me ç'rast mashtrimi përfshin disa kompani dhe transaksione komplekse të projektuara për t'i ikur kontrollit të autoriteteve hetuese, dhe duke kërkuar ekspertizë të konsiderueshme të kontabilitetit dhe financiare (*C.P. dhe të tjerë kundër Francës,* nr. 36009/97, Aktgjykim i 1 gushtit 2000, paragrafi 30).

81. GJEDNJ po ashtu thekson në praktikën e saj gjyqësore se edhe pse një çështje mund të jetë komplekse, Gjykata nuk mund t'i konsiderojë periudhat e gjata të pasivitetit të pashpjegueshëm si "*të arsyeshme*" (shih rastin e GJEDNJ-së, *Adiletta dhe të tjerët kundër Italisë,* nr. 13978/88, 14236/88 and 14237/88, Aktgjykim i 19 shkurtit 1991 paragrafi 17, ku kishte një periudhë të përgjithshme prej 13 (trembëdhjetë) viteve dhe pesë muajve, duke përfshirë një vonesë prej 5 (pesë) viteve midis referimit të çështjes nga gjyqtari hetues dhe marrjes në pyetje të të akuzuarve dhe dëshmitarëve dhe një vonesë prej një 1 (viti) dhe 9 (nëntë) muajve midis kohës në të cilën çështja iu kthye gjyqtarit hetues dhe fillimit të gjykimit).

82. Në rastin konkret, Gjykata vëren se rasti i parashtruesve të kërkesave ndërlidhet me dyshimin për bashkëkryerje të veprës penale të "*Trajtimit të pandërgjegjshëm mjekësor*„ në cilësinë e mjekëve për operimin e të ndjerit A.G në vitin 2003, nga e cila aktakuzë të njëjtit u liruan nga Gjykata Themelore në vitin 2023. Gjykata vë në pah se procedura penale në rastin konkret përfshin vetëm dy palë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve nga fusha e mjekësisë. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore prej kthimit në rigjykim të çështjes penale nga Gjykata Supreme në vitin 2012, përveç (i) një aktvendimi për shpalljen e saj si jokompetente në pikëpamje territoriale dhe lëndore në vitin 2015, i cili aktvendim, brenda 1 (një) muaji, u ndryshua nga Gjykata e Apelit ashtu që iu kthye rasti në kompetencë, dhe (ii) ndryshimit të departamentit përgjegjës brenda Gjykatës Themelore në vitin 2016, nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata Themelore deri në vitin 2022, kur filloi të mbajë seanca gjyqësore, ka qenë pasive në zhvillimin e procedurës penale.

83. Gjykata duke iu referuar edhe rrethanave faktike të rastit që ndërlidhen me zhvillimin e procedurës penale, gjen se rasti nuk ishte i ndërlikuar për të justifikuar periudhat e gjata të pasitivitetit të pashpjegueshëm.

*(b) sjellja e parashtruesit të kërkesës*

84. Në këtë kontekst të procedurës penale, GJEDNJ thekson se paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së nuk kërkon që parashtruesit të bashkëpunojnë aktivisht me autoritetet gjyqësore, dhe as nuk mund të fajësohen për përdorimin e mjeteve juridike që janë të qasshme në rendet juridike të brendshme. Megjithatë, GJEDNJ konsideron se sjellja e parashtruesve përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet gjykatave në rast se kryejnë disa veprime që vonojnë procedurën penale siç janë (i) sfidimi sistematik i gjyqtarëve; dhe (ii) veprimet që mund të sugjerojnë pengim të qëllimshëm të saj; apo (iii) rastet e arratisjes së parashtruesve (shih rastet e GJEDNJ-së, *Eckle kundër Gjermanisë*, rast i cituar më lart, paragrafi 82; dhe *Sociedade de Construções Martins dhe Vieirra, LDA dhe të tjerët kundër Portugalisë*, nr. 56637/10 dhe 5 të tjerë, Aktgjykiim i 30 tetorit 2014, paragrafi 48, *Vayiç kundër Turqisë*, nr. 18078/02, Aktgjykim i 20 qershorit 2006 paragrafi 44).

85. Lidhur me sjelljen e parashtruesve të kërkesave, Gjykata vëren se të njëjtit kishin përdorur mjetet juridike sipas radhës dhe se më 22 tetor 2015 dhe 3 tetor 2022, parashtruesit e kërkesave parashtruan kërkesa për hedhjen e aktakuzës, për të cilat veprime konsideron se nuk mund të kenë ndikuar në vonesën e Gjykatës Themelore për shqyrtimin e aktakuzës së tyre, por në të kundërtën kanë nxitur zhvillimin e mëtejmë të saj.

*(c) sjellja e autoriteteve relevante*

86. Gjykata vë në dukje qëndrimin parimor të GJEDNJ-së se paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë

edhe detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së, *Abdoella kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 24; *Dobbertin kundër Francës*, nr. 13089/87, Aktgjykim i 25 shkurtit 1993, paragrafi 44). Ky parim vlen edhe në kontekstin e arritjes së reformave të mëdha në sistemin gjyqësore, prej të cilave mund të priten vonesa të arsyeshme (shih rastin e GJEDNJ-së, *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 and 17766/19, Aktgjykim i 12 tetorit 2021, paragrafi 94).

87. Për më tepër, GJEDNJ konsideron se gjykatat vendase mbajnë përgjegjësi edhe për mospjesëmarrjen e pjesëmarrësve përkatës në procedurë penale (si dëshmitarët, të bashkëakuzuarit dhe përfaqësuesit e tyre), si rezultat i të cilit shqyrtimi gjyqësor do të duhej të shtyhet (shih rastin e GJEDNJ-së, *Tychko kundër Rusisë*, nr. 56097/07, Aktgjykim i 11 qershorit 2015, 2015, paragrafi 68). Nga ana tjetër, gjykatat vendase nuk mund të fajësohen për një vonesë të konsiderueshme në procedurën e shkaktuar nga gjendja shëndetësore e parashtruesit (shih rastin e GJEDNJ-së, *Yaikov kundër Rusisë*, nr. 39317/05, Aktgjykim i 18 qershorit 2015, paragrafi 76).

88. Lidhur me sjelljen e autoriteteve relevante dhe kompetente, Gjykata, pas dorëzimit të kërkesës së parashtruesit të parë të kërkesës në Gjykatë, më 31 korrik 2023, ka njoftuar Gjykatën Themelore përkitazi me kërkesën e tij, dhe të njëjtës i ka dhënë mundësinë që të parashtrojë komente përkitazi me rastin.

89. Gjykata rikujton komentet e Gjykatës Themelore, të dorëzuara më 3 gusht 2023, ku, ndër të tjera, theksoi se: *"Duke iu kërkuar falje që nuk të japim përgjigje në mënyrë të detajuar lidhur me këtë çështje, por është fakt se Gjykata Themelore në Gjakovë, ka pasur në procedurë çështjen penale lëndën me numër P.nr.724/15, në numër të sistemit elektronik Smil:2022:133184, ku ka qenë në vendosje tek Gjykatësja [I.H], e cila çështje ka marr epilog përfundimtarë ku edhe është vendosur sipas aktgjykimit lirues P.nr. 724/15 të dt. 02.05.2023, për të cilën çështje palët kanë parashtruar ankesë dhe tani kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë me ankesë, e cila lëndë nga Gjykata jonë është përcjellë sipas ankesës dhe është pranuar me dt. 23.06.2023 në Gjykatën e Apelit dhe për këtë arsye nuk mund të paraqesim përgjigje të detajuar lidhur me këtë kërkesë."*

90. Gjykata rikujton se Prokuroria Publike kishte ngritur aktakuzë kundër parashtruesve të kërkesave më 7 qershor 2006, për të cilën Gjykata e Qarkut kishte vendosur në vitin 2011 me aktgjykim dënues, të cilin e kishte kthyer Gjykata Supreme në rigjykim më 27 shtator 2012. Gjykata ripërsërit gjithashtu se Gjykata Themelore kishte vendosur për aktakuzën e parashtruesve të kërkesave më 2 maj 2023 përmes një aktgjykimi lirues, çka rezulton se i janë dashur 10 (dhjetë) vjet, 7 (shtatë) muaj e 5 (pesë) ditë që të vendosë rastin konkret në procedurë të rigjykimit, respektivisht t'i lirojë parashtruesit e kërkesave nga akuza. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se Gjykata Themelore prej momentit të kthimit në rigjykim të lëndës, respektivisht vitit 2012 deri në vitin 2022 kishte qenë kryesisht pasive, dhe se përgjatë kësaj periudhe, (i) në vitin 2015 kishtë shpallur veten jokompetente në pikëpamje territoriale dhe lëndore, i cili aktvendim, brenda 1 (një) muaji, u ndryshua nga Gjykata e Apelit ashtu që iu kthye rasti në kompetencë; si dhe (ii) në vitin 2016, ndryshoi departamentin përgjegjës brenda saj. Gjykata po ashtu vëren se gjatë intervalit kohor 18 tetor 2022 dhe 27 prill 2023, Gjykata Themelore kishte mbajtur gjithsej 12 (dymbëdhjetë) seanca gjyqësore deri në dhënien e aktgjykimit lirues. Gjykata vlerëson se Gjykata Themelore rifilloi mbajtjen e seancave gjyqësore si pasojë e kërkesës për hedhje të aktakuzës nga ana e parashtruesve të kërkesave, të dorëzuar më 3 tetor 2022.

91. Gjykata po ashtu përsërit pretendimet e parashtruesit të dytë të kërkesës, cili thekson se rasti i tyre ishte vendosur nga Gjykata Themelore më 2 maj 2023, vetëm 1 (një) ditë para

se vepra penale, për të cilën ishte akuzuar, të arrijë parashkrimin absolut. Gjykata në këtë kontekst, vëren se dënimi maksimal i aplikueshëm për veprën penale për të cilën janë akuzuar parashtruesit, ishte 8 (tetë) vjet, çka sipas KPRK-së, dënimi i tillë parashkrimin relativ e arrin pas 10 (dhjetë) viteve, ndërsa parashkrimin absolut e arrin pas 20 (njëzet) viteve. Më saktësisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret parashkrimi absolut arrihej pikërisht më 3 maj 2023, respektivisht, 1 (një) ditë pasi që Gjykata Themelore kishte vendosur përmes aktgjykimit lirues.

92. Thënë këtë, Gjykata konstaton se zvarritjet e procedurës në rastin konkret iu atribuohen gjykatave të rregullta sepse atyre iu deshën rreth 20 (njëzet) vjet për të vendosur në lidhje me (pa)fajësinë e parashtruesve të kërkesave për një vepër penale që pothuajse kishte arritur parashkrimin absolut, gjegjësisht: (i) 14 (katërmbëdhjetë) vjet e 9 (nëntë) muaj e 10 (dhjetë) ditë për parashtruesin e parë të kërkesës KI75/23, ndërsa (ii) 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, 3 (tre) muaj e 25 (njëzet e pesë) ditë për parashtruesin e dytë të kërkesës KI225/23, prej momentit kur gjykata ka juridiksion kohor e deri në parashtrimin e kërkesave të tyre para Gjykatës.

*(c) Rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest*

93. Lidhur me kriterin e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila sqaron se një kategori e rasteve kërkon zgjidhje të veçantë ekspeditive. Sipas kësaj praktike, shembuj që kërkojnë kujdes të veçantë dhe zgjidhje me prioritet janë rastet kur parashtruesi gjendet në paraburgim në procedurë paraprake *(*shih rastin e GJEDNJ-së, *Abdoella kundër Holandës,* cituar më lart, paragrafi 24*)* apo kur koha që është shpenzuar për të përcjellë dokumente në Gjykatën Supreme në dy raste ka qenë më e gjatë se 21 (njëzet e një) muaj nga gjithsej 52 (pesëdhjetë e dy) muaj për të zgjidhur çështjen juridike e (shih rastin e GJEDNJ-së, *Starokadomskiy kundër Rusisë (nr. 2),* nr. 27455/06 Aktgjykim i 13 marsit 2014, paragrafët 70-71). Megjithatë, GJEDNJ konsideron se në rastet kur parashtruesi është figurë publike dhe rasti tërheq vëmendje mediatike, nuk është e domosdoshme që rasti të ketë trajtim prioritar (shih rastin e GJEDNJ-së, *Liblik dhe të tjerët kundër Estonisë,* cituar më lart, paragrafi 103*)*.

94. Thënë këtë, Gjykata vlerëson se bazuar në praktikën e konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së, parashtruesit e kërkesave janë akuzuar për vepër penale gjatë ushtrimit të profesionit të tyre, dhe se në rastin konkret pas 20 (njëzet) vjetësh janë liruar nga akuza. Gjykata konsideron se pavarësisht praktikës së lartcekur gjyqësore të GJEDNJ-së, edhe pse parashtruesit e kërkesave nuk kanë qenë në paraburgim, kjo çështje ka kërkuar "*kujdes të posaçëm*" (*particular diligence*) pasi që natyra e veprës penale ndërlidhet me gabimin potencial të mjekut gjatë ushtrimit të profesionit, reputacioni i të cilit varet nga zgjidhja e çështjes juridike.

*Përfundim*

95. Si përfundim, Gjykata rikujton se në rastin konkret, gjykatat e rregullta kishin nxjerrë aktgjykim lirues për parashtruesit e kërkesave pas 20 (njëzet) viteve për veprën penale që për 1 (një) ditë, do të arrinte parashkrimin absolut të ndjekjes penale.

96. Gjykata vlerëson se rasti konkret nuk ka qenë i ndërlikuar sepse (i) gjykatat e rregullta kanë pasur për detyrë që të konstatojnë fajësinë e 2 (dy) parashtruesve të kërkesave në lidhje me një vepër penale gjatë ushtrimit të profesionit të mjekut; (ii) dhe se procedura as nuk ishte ndërlikuar më tej nga veprimet e parashtruesve të kërkesave, të cilët kishin ndjekur mjetet juridike sipas radhës; kurse, (iii) gjykatave të rregullta iu është dashur 20 (vite) për të konstatuar me vendim të formës së prerë nëse parashtruesit e kërkesave janë fajtor ose jo për një vepër penale që pothuajse ishte parashkruar në mënyrë absolute në

kohën kur është nxjerrë aktgjykimi lirues. Gjykata rithekson se mos zgjidhja e çështjes penale kundër parashtruesve të kërkesës brenda një afati të arsyeshëm përveçse është tejzgjatje e pajustifikuar e procedurave gjithashtu mund të konsiderohet mohim i drejtësisë (shih *mutatis mutandis,* rastin e Gjykatës në kontekst të procedurës civile KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana*, cituar më lart, paragrafët 103 dhe 108, si dhe referencat e përdorura aty).

97. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se kohëzgjatja e procedurës, prej: (i) 14 (katërmbëdhjetë) viteve, 9 (nëntë) muajve e 10 (dhjetë) ditëve për parashtruesin e parë të kërkesës KI75/23, ndërsa (ii) 15 (pesëmbëdhjetë) viteve, 3 (tre) muajve e 25 (njëzet e pesë) ditëve për parashtruesin e dytë të kërkesës KI225/23, prej kur gjykata ka juridiksion kohor e deri në parashtrimin e kërkesave të tyre respektive para Gjykatës, në rrethanat e rastit konkret, nuk mund të konsiderohet e arsyeshme.

98. Për pasojë të lartcekurave, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

**Efektet e këtij Aktgjykimi për parashtruesit e kërkesave**

99. Bazuar në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ripërsërit se, nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih rastin e Gjykatës, KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, cituar më lart, paragrafi 104 dhe referencat e përdorura aty).

100. Gjykata ripërsërit se, në disa raste, gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të "*shpërblimit të drejtë*", sidomos kur parashtruesi ka mundur të pësojë një dëm jo material. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jo material pranë gjykatave të rregullta (shih rastin e Gjykatës, KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, cituar më lart, paragrafi 105 dhe referencat e përdorura aty).

**PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe pikën (a) të paragrafit (1) rregullit 48 të Rregullores së punës, më 5 shkurt 2025, njëzëri:

**VENDOS**

I. TË SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;

I. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe

II. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

| | |
|---|---|
| **Gjyqtari raportues** | **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese** |
| Bajram Ljatifi | Nexhmi Rexhepi |